

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-070/15

**Prishtinë,
19 Tetor 2016**

Në çështjen juridike të:

L. R. S.

Pala përgjegjëse në kërkesë/ Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr KPCC/D/C/240/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA06559), të datës 30 prill 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 19 Tetor 2016 mori këtë

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga L. R. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/240/2014, e datës 30 prill 2014, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/240/2014, i datës 30 prill 2014 vërtetohet në lidhje me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA06559.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 2 shkurt 2007, L. R.S. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me të cilën ka kërkuar konfirmimin e të drejtës së shfrytëzimit të lokaleve afariste – shitores, me sipërfaqe prej 13,5 m² që gjendet në ngastrën nr.2161 në Zonën Kadastrale të Komunës së Ferizajt, rruga "Filip Višnić" (tani e tutje: prona e kërkuar). Ai pretendon se e ka humbur posedimin si rezultat i konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 1998-1999.
2. Në mbështetje të kërkesës, pala ankuese *ndër të tjera* ka paraqitur dokumentet në vijim:
 - Lejen e ndërtimit nr.351-340 të datës 28 gusht 1998 sipas së cilës pala ankuese lejohet të ndërtojë një objekt të përkohshëm për biznesin e tij.
 - Vendimin nr.464-08-54817/98 të datës 13 tetor 1998 me të cilin palës ankuese i është dhënë në shfrytëzim një pjesë (13,5 metra katrorë) e ngastrës kadastrale nr.2161 në Ferizaj.
 - Pëlqimin nr.01-19 të lëshuar më 30 janar 1997 me të cilin pala ankuese ka marrë jelen e punës.
 - Përshkrimin e pronës së kërkuar të datës 30 janar 1997.
3. Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) gjeti *ex officio* Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme e cila paraqet Komunën e Ferizajt si pronarin e vetëm të ngastrës kadastrale nr 2161.
4. Më 2 mars 2007, AKP-ja ka bërë identifikimin e pronës së kërkuar dhe ka gjetur se objektet afariste ishin të zaptuara nga B. B. i cili ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje por nuk ka pretenduar në të drejtat pronësore mbi pronën.

5. Askush nuk ka shprehur interesim për të marrë pjesë në procedurë lidhur me pronën në fjalë brenda afatit ligjor 30 ditësh, dhe prandaj, në përputhje me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, kërkesa mbeti e pa kontestuar.
6. Më 30 prill 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK), përmes vendimit të tij KPPC/D/C/240/2014, ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. Në arsyetimin e vendimit, KKPK-ja tregon se në bazë të provave paraqitësi i kërkesës kishte të drejtën e shfrytëzimit të përkohshëm të pronës së kërkuar dhe prandaj kishte autorizim të ndërtonte një objekt të luajtshëm në pronën e kërkuar. Në përputhje me paragrafin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat për ri-posedim të pronës së paluajtshme private duke përfshirë atë komerciale.
7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 24 tetor 2014. Më 13 nëntor 2014 pala ankuese ka paraqitur ankesë në Gjykatë Supreme.

Pretendimet e paraqitësit të kërkesës/palës ankuese

8. Pala ankuese në ankesën e tij pretendon se prona e kërkuar është uzurpuar dhe dëshiron që Gjykata Supreme ta shqyrtojë tërë dokumentacionin dhe ta përcaktojë gjendjen faktike.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

9. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të përcaktuar me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut të ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079). Gjykata Supreme ka juridiksion mbi ankesën kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

10. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe të pretendimeve të palës ankuese, në përputhje me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar.
11. KKPK-ja ka bërë vlerësim të saktë të provave kur ka vendosur se kërkesa bie jashtë juridiksionit të tij. KKPK-ja ka dhënë shpjegime dhe sqarime të plota, gjithëpërfshirëse, të qarta, të sakta dhe rrjedhimisht të ligjshme lidhur me faktet vendimtare për marrjen e vendimit të drejtë.
12. Në përputhje me paragrafin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079, pala ankuese ka të drejtën e urdhrit nga KKPK-ja për ri-posedim të pronës nëse ai jo vetëm që dëshmon të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi **pronën e paluajtshme private**, duke përfshirë atë bujqësore apo komerciale, por edhe se tani nuk ka mundësi t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave të lidhur drejtpërdrejt ose si rezultat i konfliktit të armatosur që ndodhi në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Sipas kësaj dispozite juridiksioni i Komisionit për Kërkesa Pronësore i AKP-së, sikurse edhe i Gjykatës Supreme është i kufizuar vetëm në gjykimin dhe zgjidhjen e kërkesave mbi të drejtat pronësore mbi **pronën e paluajtshme private**, duke përfshirë pronën e paluajtshme bujqësore dhe komerciale.
13. Gjykata Supreme shënon se në bazë të dokumenteve që pala ankuese i ka dorëzuar, atij i është dhënë një pjesë e ngastrës nr.2161 në Ferizaj për ndërtimin e një objekti të përkohshëm- shitore, e cila konsiderohet si objekt i luajtshëm.
14. Vetë toka është pronë shoqërore siç mund të shihet nga certifikata e sipërpërmendur mbi të drejtat e pronës së paluajtshme. Sipas nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore (Ligji nr. 03/L-154) ndërtesat e përkohshme montazhe, kioskat, dhe strukturat e përkohshme, sikurse në rastin konkret, nuk konsiderohen objekte të paluajtshme.
15. Prandaj, vendimi i apeluar as nuk përmban shkelje esenciale e as zbatim të gabuar të ligjit material dhe të procedurës. Ky vendim nuk mbështetet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
16. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i KKPK-së vërtetohet sa i përket lëndës që vendoset me këtë aktgjykim (KPA06559).

Këshillë juridike

17. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, siç është ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Beshir Islami, Gjyqtar

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it